



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:160958

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05809174

C.nr.702/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, si gjykatë civile e shkallës së parë në përbërje prej gjyqtarit individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen juridiko-civile të paditëses P. M.-F. nga L., të cilën e përfaqëson Arif Hasi av. nga Drenasi, me autorizim kundër të paditurës Komunës së Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Behar Krasniqi av. publike, me autorizim, për shkak të kompenzimit të t'ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.11.06.2024, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e precizuar e paditëses P. M.-F. nga L., si e **BAZUAR**, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtorati i Arsimit në Lipjan, që paditëses në emër të Kualifikimit diferencën e pagesës dhe atë prej 27% të pagës bazë për periudhën prej dt.08.07.2018-21.05.2021 t'ia paguaj shumën prej 113-€ për çdo muaj, pra për 34 muaj apo shumen e përgjithshme prej 3,842.00-€, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën prej 403-€, e të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënimin të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja P. M.-F. nga L., në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi ndaj të paditurës Komunës së Lipjanit, për shkak të kompenzimit të të ardhurave personale në emër të kualifikimit.

Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura në shkollën fillore "V. K." në B. K. L., si mësimdhënëse e Gjuhës Angleze, me kontratë pune në kohë të pa caktuar. Me dispozitën e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, është paraparë se të punësuarve i takon kompensimi shtesë në emër të kualifikimit-gradimit prej 27% të pagës bazë.

Me parashtrësën e dt.10.06.2024 pala paditëse e ka bërë precizimin e lartësisë së kërkesëpadiisë më konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe precizimit të saj për faktin se paditësja i plotëson kushtet për plotësimin e diferencës në emër të kualifikimit në bazë të Vendimit të Qeverisë nr.01/33 të dt.29.08.2008. ku baza dhe lartësia e kërkesëpadiisë u vërtetua edhe me administrimin e provave andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadiinë e paditësit ta aprovon si të bazuar.

Shpenzimet e procedure i ka kërkuar sipas TA-së dhe atë për përpilimin e padisë, precizimin, një seancë gjyqësore dhe taksën gjyqësore për padi.

Në të përgjigjur në padi në formë të shkruar e paditura e ka kontestuar si të pa bazë ligjore dhe në bazë të kontratës ku është punësuar paditësi askund nuk ceket se punëtori e gëzon të drejtën në emër të kualifikimit. Ndër të tjerat ka theksuar se sipas Ligjit të Punës Nr.03/L 212 i cili rregullon kontestet e punës askund nuk ceket se punëtorëve të arsimit ju takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike. Poashtu Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk e ka bërë harmonizimin e saj me Ministrin e Financave që neve si Komunë me Qarkore Buxhetore të na lejohet ngritja e tavanit të pagave në mënyrë që pastaj të planifikojmë edhe pagesat shtesë për stafin arsimor në kuadër të kodit ekonomik Paga dhe Mëditje dhe e paditura nuk ka mundësi financiare të i paguaj. Nga lista e pagave shihet se përveç pagës punëtorët marrin edhe shtesën në emër të kualifikimit dhe nga kjo shihet se paditësi paguhet për kualifikim të tij, andaj kërkesëpadia është e pa bazuar.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se në tërsi pranë të gjitha kundërshtimeve të paraqitura dhe ka theksuar se Vendimi i Qeverisë në pikën 8 përcakton organet kompetente për zbatimin e tij e që nuk figuron që të jetë Komuna, andaj ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave dhe atë me shiqimin dhe leximin e kontratës së punës nr.04-112-813/2992 e dt.01.09.2020, me shiqimin dhe leximin e vërtetimit të përvojës së punës të dt.19.07.2021, me shiqimin dhe leximin e Diplomës të lëshuar nga Kolegji AAB me titull Bachelor i Gjuhës Angleze të dt.05.07.2013 së bashku me licencën për mësimdhënës, si dhe me shiqimin dhe leximin e listës së pagës për muajin Dhjetor të vitit 2019, e të cilat prova gjykata i administroj dhe i vlerësoj në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ku vërtetoi këtë gjendje faktike:

a) Paditësja P. M.-F. ka themeluar marrëdhënie pune tek e paditura në FMU “V. K.” në B., si mësimdhënëse e lëndës gjuhës angleze që nga dt.01.09.2014 e tutje në kohë të pa caktuar, respektivisht deri me dt.21.05.2021 kur edhe ka marrur pushim pa pagesë.

b) Paditësja gjatë kësaj periudhe respektivisht gjatë periudhës kontestuse dt.08.07.2018-21.05.2021 në procesin mësimorë ka punuar me kualifikim bachelor Diplomë nga Kolegji AAB në drejtimin e gjuhës angleze.

Këto fakte respektivisht faktet nën a). gjykata i vërtetoi nga kontrata e punës nr.04-112-813/2992 e dt.01.09.2020 e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës dhe vërtetimi i përvojës së punës i dt.19.07.2021. Ndërsa faktet nën b) gjykata i vërtetoi nga Diploma Universitare e lëshuar nga Kolegji AAB në drejtimin e gjuhës angleze e datës 05.07.2013.

Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 të dt.29.08.2008 parashihet se nga 1 Shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësve etj., do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me një ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Me dispozitat e nenit 8 të LMD-së, të R. së Kosovës, parashihet se “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Ndërsa me dispozitën e nenit 245 po të njëjtit Ligj parashihet se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e lartcekura gjykata vjen në përfundim se e paditura përkundër kërkesës së bërë nga paditësja nuk ia ka paguar këtë shtesë që i takon sipas Vendimit të Qeverisë nr.1/33 dt.29.08.2008 në emër të Kualifikimit të pagës

bazë prej 27% për periudhën prej dt.08.07.2018-21.05.2021 t'ia paguaj shumën prej 3,842.00-€, respektivisht ia ka paguar pjesërisht dhe pjesërisht në shumën mujore prej 113 euro nuk ia ka paguar e që për periudhën kontesuse kjo pjesë e pa paguar është në lartësi më konkretisht siç është vendosur si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj kundërshtimet e të paditurës të theksuara në përgjigje në padi dhe seancën kryesore, mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pabazuara me arsyetimin se sa i përket kualifikimit, pra shtesës të pagës bazë për kualifikim gjykata këtë të drejtë e gjykoj siç u tha më lartë në bazë të Vendimit të Qeverisë nr.01/33 e dt.29.08.2008 për rritje i cili vendim ka qenë në fuqi deri në Ligjin për Pagat dhe mbi bazën e këtij vendimi janë përcaktuar pagat dhe mbi këtë bazë ende mësimdhënësit i marrin pagat nga punëdhënësi mirëpo shtesa në emër të kualifikimit është paguar deri në nxjerrjen e ligjit për paga por me një shtesë të llogaritur më parë ku paga bazë ka qenë më e ulët dhe me rritjen e pagës bazë nuk është rritur shtesa në kualifikim andaj Gjykata e gjykoj vetëm diferencën e shtesës në kualifikim.

Meqenëse pala paditëse e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet, gjykata në pajtim me nenin 452 dhe 453 të LPK-së, e detyrojë të paditurën që paditësit t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00-€, për përpilimin e parashtrësës për precizim në shumë prej 104.00-€, për 1 (një) seanca gjyqësore të përfaqësuar nga i autorizuari e palës paditëse shumë nga 135-€, si dhe në emër të taksës për padi në shumë prej 60.-€, apo shumen e përgjithshme prej 403-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për çka është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të dispozitave të lartcekura si dhe nenit 136 të LMD-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN

C.nr.702/21 me dt.11.06.2024

**GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtijë aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësajë gjykatë.

Numri i lëndës: 2021:160958
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05809174